



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 2.

Prishtinë, më 03.10.2017, në ora 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu -Kodra, Armend Zemaj, Fitore Pacolli, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

Munguan: Driton Çausi, Fikrim Damka, Zenun Pajaziti dhe Glauk Konjufca.

E ftuar: Dhurata Hoxha-Ministre për Integritet Evropian.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu- Kodra, kryetare e Komisionit.

Kryetarja Blerta Deliu –Kodra, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë;

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Kryetarja i njoftoi se ky projektligj ka ardhur në Kuvend me procedurë të përsheptuar dhe për shkak të kostos financiare, që do të përfitojë Kosova, të mos ketë vonesa në miratim.

Për të diskutuar lidhur me këtë marrëveshje financiare në Komision është ftuar Dhurata Hoxha, ministre e Integriteteve Evropiane. Ajo i uroj suksese në emërimin si ministre e Integriteteve Evropiane

Armend Zemaj tha se e kupton përsheptimin e procedurave, por mendon që për një Projektligj të rëndësishëm së veçantë do t' na duhen së paku 48 orë, andaj lutet që në të ardhmen për çështje të tilla të kenë njoftime paraprake mbi të gjitha duke marrë parasysh edhe gjithmonë prezencën e raportimit të ministres apo ministrave të linjës në kuadër të agjendës evropiane.

Ndoshta e keni arsyen e thirrjes së shpejtë të këtij takimi, por nga bisedat paraprake ekziston mundësia të kërkohet plotësim ndryshimit i rendit të ditës së seancës, edhe pse sipas Rregullores së Kuvendit duhet të jetë në fillim të seancës plenare, nuk e di procedurën si do të paraqitet kërkesa, por sidoqoftë ne mund ta vazhdojmë punën tonë në Komision, kurse pjesa tjetër le të mbetet në vullnet të deputetëve dhe të seancës plenare.

Fitore Pacolli vlerësoi se është shumë me rëndësi që ne me kohë ta marrim secilin projektligj që vije në Kuvend, në mënyrë që të kemi mundësi ta lexojmë që të jemi të përgatitur dhe t'i japim komentet tona! Sot nuk jemi të përgatitur, e dimë rëndësinë që kanë fondet e IPA- për Kosovën, por e rëndësishme është që para se të marrim vendime të dimë se çka do të diskutohet.

Ahmet Isufi tha se duhet pasur parasysh rëndësinë e këtij Projektligji që është një marrëveshje financiare që garanton 70.15 mil. € nga BE-ja.

Por në të ardhmen materialet duhet të vijnë me kohë që komisionet t'i shqyrtojnë në mënyrë të rregullt, e jo të ngutshme, por në këtë rast e dimë që më herët është afruar ky Projektligj, por vonesat ne krijimin e Qeverisë dhe vonesat që janë dalë e kanë bërë që ky Projektligj është kërkuar të miratohet me procedurë të përsheptuar, nga kolegët kërkoj mirëkuptim në mënyrë që në të ardhmen të mos na vijnë Projektligjet që të detyrohet Komisioni në mënyrë të përsheptuar t'i kryej obligimet.

Kryetarja shtoi se, si udhëheqëse e këtij komisioni, së bashku me anëtarët e komisionit nuk do të lejojmë që praktikat e përsheptimit të ligjeve ta karakterizojnë Komisionin për Integritete Evropiane duke qenë të vetëdijshëm për specifikat dhe fushën e rëndësishme që ka.

Lidhur me procedurën e përsheptimit të procedurës së miratimit të këtij projektligji njoftoi se në mbledhjen e fundit të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, më 20 shtator një zëri është vendosur se miratimi i Projektligjit nr. 06/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian të bëhet, më 3 tetor 2017, me shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, në mbledhje të Kryesisë kanë marrë pjesë përfaqësuesit e subjekteve politike që i kemi këtu dhe besoj që secili jeni

të njoftuar që ky është vendim i Kryesisë së Kuvendit dhe nuk është që unë po vij me diçka të re ta iniciojë në Komision.

Ne vazhdim ia dha fjalën ministres për Integritet Evropian, znj. Dhurata Hoxha, që të njoftojë lidhur me përmbajtjen dhe obligimet që i kanë institucionet e Kosovës sa i përket fondit IPA.

Dhurata Hoxha, ministre tha se marrëveshja financiare IPA 2016 pjesa e parë ndërmjet Kosovës dhe BE-së është nënshkruar në prill të këtij viti dhe kjo marrëveshje financiare rregullon zbatimin e programit IPA 2016, pjesa e parë, që përfshin 6 projekte, të cilat do të ndihmojnë në përafrimin me legjislacionin e BE-së, të drejtat e komuniteteve, rritjen e konkurrencës për ndërmarrjet kosovare, si dhe përkrahjen për lidhjen më të mirë të arsimit me tregun e punës dhe politikën sociale. Në tërësi programi konsiston me financimin e 45.5 mil.€ nga ana e BE-së për Kosovën, ndërsa shuma totale e përfshirë është 71.15 mil.€, ku përfshihen edhe dhënia e kredive nga Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim në vlerë prej 20.5 mil për operatorët privat, si dhe një shumë bashkëfinancimi nga ana e Kosovës në vlerë 4.75 mil.

Njoftoj se afati përfundimtar për hyrje në fuqi e kësaj marrëveshje financiare është 31 dhjetori i këtij viti. Andaj ftoj deputetët që ta miratojnë projektligjin dhe menjëherë pas kësaj të finalizohet procedura që sa më parë të bëhet hyrja në fuqi me qëllim që fondet e parapara me këtë marrëveshje të fillojnë zbatimin për projektet, të cilat janë projektet të cilat janë planifikuar.

Ilir Deda pyeti ministren se a janë ndarë mjetet në buxhet për vitin 2017 prej 1mil.€ për Young Cell Scheme.

Ministria tha se me rishikimin e buxhetit është rregulluar 500.000 € janë ndarë për vitin 2017 dhe 500.000 € në kuadër të Ministrisë së Integritetit për vitin e ardhshëm final.

Armend Zemaj pyeti ministren lidhur me dy çështje:

1. Ai i tha ministres se neve çka na intereson është zotimi juaj për implementimin e plotë të marrëveshjes, sa jeni të gatshëm që për këtë periudhë e mbetur deri më 31 dhjetor 2017 ta implementoni në tërësi pjesën e 71 Mil. sa është tash në shifër të saktë.

2. Edhe këtu po shihet se pjesa integrale e marrëveshjes është fusnota, nuk e di se si është përcjellë deri te ju, por kërkoj të jeni të kujdesshëm, është Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës që është miratuar, që ne do t'i referohemi në të gjitha dokumentet me „Republika e Kosovës“!

Ilir Deda theksoj se Marrëveshjen e stabilizim- asociimit e kemi ratifikuar me „Republika e Kosovës“, andaj ne, si komision, kemi të drejtë të dalim me amendament dhe të kërkojmë që ky Projektligj të quhet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2016 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, sepse kjo është në frymën e MSA-së, ashtu siç e kemi aprovuar, me të drejtë ndërkombëtare neve na përforcon subjektivitetin tonë ndërkombëtar pa marrë parasysh se çka shkruan brenda.

Fitore Pacolli pajtohet me parafolësin, sepse tha se ne duhet të kemi kujdes kur t'i referohemi Kosovës, duhet t'i referohemi me „Republika e Kosovës,, e jo me asterisks sepse është shumë e padrejtë.

Ministrja u përgjigj në pyetjet e deputetëve me radhë dhe tha se ne kemi përkushtim për zbatimin e plotë në përputhshmëri me marrëveshjen e cila ratifikohet në Kuvend. Ne, si Ministri e Integriteteve, jemi edhe koordinator të donacioneve, e kemi obligim të koordinohemi me ministrin e linjës që të bëhet një zbatim i plotë i marrëveshjes. Kurse sa i përket çështjes së fusnotës apo referimit të Kosovës, si Republika e Kosovës tha se e pranoj këtë vërejtje dhe padyshim që do ta zbatojmë, por pajtohem edhe me vërejtjet e juaja në fillim dhe ne do të mundohemi që projektligjet e tjera, në afatet optimale t'i dërgojmë dhe komisionet të kenë kohë të mjaftueshme për shqyrtim.

Kryetarja falënderoi ministren për raportimin dhe përgjigjet për anëtarët e Komisionit dhe hodhi në votim projektligjin.

Pas votimit kryetarja konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

1. Miratohet Projektligji nr. 06/L-003 për Ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;
2. Komisioni për Integritete Evropiane propozoi këtë amendament, si vijon;

Amendamenti 1

Në titullin e Projektligjit, para fjalës “**Kosovës**”, të shtohet fjala “**Republika e**” dhe ky ndryshim të vlejë në tërë tekstin e projektligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:55.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra